

31.866

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**  
**NR. \_\_\_\_\_ VENDIMI**

**VENDIM**  
**PER**  
**RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Sot, me date 21/7/2004, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane R. Romajok, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministria e Ekonomise, per rregjistrimin si person juridik te shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" sh.a. Libohove.

**K O N S T A T O V A :**

Kerkuesi Ministria e Ekonomise ka paraqitur kerkesen per te rregjistruar si person juridik shoqerine "Ujesjelles kanalizime" sh.a. Libohove me kohezgjatje pa afat te percaktuar, me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise, me kapital themeltar 32.430.666 leke ndare ne 32.430 aksione me vlere nominale 1000 leke secili dhe me objekt veprimtarie : Furnizimi me uje te pishem te qytetit dhe largimin e ujrave te zeza, me anetare te pare te keshillit mbikqyres: Ridvan Baxha, Luiza Mandi dhe Etleva Kondi .

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, urdheri nr. 197, date 21/6/2004 Ministrin te Ekonomise jane te plota dhe te bazuar ne ligj dhe si te tilla duhen pranuar.

**PER KETE ARSYE:**

Ne baze te ligjit nr.7667, date 28.01.1993 dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992

**V E N D O S A :**

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" sh.a Libohove me kohezgjatje pa afat te percaktuar, me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise, me kapital themeltar 32.430.666 leke ndare ne 32.430 aksione me vlere nominale 1000 leke secili dhe me objekt veprimtarie : Furnizim me uje te pishem te qytetit dhe largimin e ujrave te zeza, me anetare te pare te keshillit mbikqyres: Ridvan Baxha, Luiza Mandi dhe Etleva Kondi.

Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

**GJYQTARE**  
*Reglita Romajok*  
*[Signature]*

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ANONIME**

Ne Tirane, sot me date 21.06.2004, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me ligjet perkatese, Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

**V E N D O S I:**

1. Te krijoje Shoqerine Anonime "Ujesjelles Kanalizime" Sh.a. Libohove, me kapital 100% shtetor.
2. Objekti i Shoqerise eshte: Furnizimi i qytetit me uje te pijshem dhe largimin e ujrave te zeza.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Libohove. Ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 32,430,666 leke ndare ne 32,430 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.
5. Shoqeria ka nje zgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:
  - Z. Ridvan Baxha
  - Znj. Luiza Mandi
  - Znj. Etleva Kondi
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

  
Anastas ANGJELI  
MINISTER